

RREGULLORE

“ PER ZGJIDHJEN E KRYESISE DHE TE KRYETAREVE TE FSHATRAVE”

Mbeshtetur ne ligjin Nr 8652 date 31/07/2000 “Per Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore “nenit 45 te tij dhe ne ligjin Nr 30/2015 date 02/04/2015 nenit 14 te tij te veprohet si me poshte:

1-Zgjedhjet te zhvillohen gjate periudhes 07-30 Shtator 2015

2-Numri i anetareve te Keshillit te jete :

- a)Per fshatrat mbi 1000 banore 7 veta
- b) Per fshatrat nga 501-1000 banore 5 veta
- c) Per fshatrat nen 500 banore 3 veta

Konkretisht:

a) Jergucat,Bularat ,Bodrishte dhe Dervican do te kene nga 7 anetar

Fshatrat

b)Zervat , Pepel ,Goranxi ,Terihat ,Frashtan,Grapsh, Gline Peshkopi e poshtem, Polican Skore, Sopik ,Çatiste Kryesite do te kene nga 5(pese) anetar

Fshatrat e tjere do te kene nga 3(tre) anetar

Ne Pogon zgjedhjet do te zhvillohen per 3(tre)

3-Ne Dropullin e Poshtem dhe ne Pogon Administratoret ne bashkepunim me Administraten e Bashkise dhe Kryetaret Aktual te fshatrave te percaktojne daten dhe oren e zhvilimit te zgjedhjeve .

4-Ne Dropullin e Siperme Sekretari i Keshillit te Bashkise ne bashkepunim me administraten e Bashkise dhe Kryetare aktuale te fshatrave te percaktojne daten dhe oren e zgjedhjeve.

5-Administratoret dhe Sekretari i Keshillit te Bashkise njoftojne te deleguarit e keshillit te bashkise 5(pese) dite perpara per daten , oren dhe

vendin ku do zhvillohen zgjedhjet duke vendosur njekohesishte lajmerime ne fshatrat per te siguruar pjesmarje sa me te gjere .

6-Ne mbledhje mund te marrin pjese gjithë banoret e fshatit me moshe mbi 18 vjeç me te drejte vote .

7-Çdo person mund te propozoj nje kandidat per anetar Keshilli ose te vete-propozohet .

8-Para mbledhjes zgjidhen tre veta (qe s,do jene kandidat) ne komisionin e organizimit te mbledhjes dhe numerimit te votave .

9-Nga ana e Komisionit dhe te deleguarve rregjistrohen propozimet e bera duke shenuar emrat ne fletet e votimit.

Votimi behet individualisht i fshehte .Fletet e votimit firmosen nga komisioni dhe te deleguarit .

Rregjistrohen pjesemaresit ne mbledhje(n,q-se egziston mundesia) fotokopjohen fletet e votimit .

10-Pas perfundimit te votimit behet numerimi i votave te vlefshme per çdo kandidat duke nxjere dhe anetaret e Keshillit (7, 5,3 sipas rastit) Vote te vlefshme konsiderohet ajo ,qe ka votuar nga nje deri ne numrin e propozuar (7,5,3) per anetar keshilli .

11 -Nga te deleguarit shpallen anetaret e Kryesise te cilet ne mbledhjen e pare me votim te fshehte zgjedhin Kryetarin e fshatit .

12-Nuk mund te jete kandidat per anetar keshilli nje person qe s,eshte ne mbledhje ose nuk pranon te kandidtoj .

13-Nga te deleguarit dhe komisioni mbahet Proces-Verbali per rezultatet e zgjedhjeve

Te evidentohen dhe kandidatet e tjere me me shume vota qe nuk u zgjedhen ne menyre qe ne rast doreheqje te mos zhvillohen prape zgjedhje .

14-Aty ku ka ndryshim te Kryetareve, te behet dhe dorezimi i Inventarit,vulave

15 -Nga ana e Administrates se Bashkise te merren te gjitha masat per plotesimin dhe paisjen e te deleguarve me bazen e nevojeshem materiale (Fletet e Votimit dhe Proces-verbalet)si dhe pjesemarjen e tyre (pervec Administratoreve qe do te jene ne cdo fshat. (ne tere teritorin e Bashkise).

NR. 8000

Nr. 8000

shet

101

16-Fletet e votimit dhe Proces-verbalet nga ana e te deleguarve do depozitohen tek Sekretari dhe dorezimi i Inventarit nga ish Kryetaret .

17- Neqofte se do te kete barazim votash ,do hidhet me short .

Kryetari i Keshillit te Bashkise
Panajot LULO
